



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1214

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " Cactus " Sh.a., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E SHËNDETËSISË në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit të E- Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (HIFIS) me numër të prokurimit 206-25-7982-2-1-1, me 18/02/2026, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE " Cactus " Sh.a. me nr. 2025/1214, e datës 08/12/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit të E- Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (HIFIS) me numër të prokurimit 206-25-7982-2-1-1.
2. **Anulohet** B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të MINISTRIA E SHËNDETËSISË, ndërsa, aktiviteti i prokurimit Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit të E- Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (HIFIS) me numër të prokurimit 206-25-7982-2-1-1, kthehet në rivlerësim.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " Cactus " Sh.a.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.09.2025 MINISTRIA E SHËNDETËSISË., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit të E- Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (HIFIS) me numër të prokurimit 206-25-7982-2-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 127,000.00€.

Me 19.11.2025 MINISTRIA E SHËNDETËSISË., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë GOE "RENER SHPK & PBC SHPK.

Me 24.11.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 28.11.2025 AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 08.12.2025, OE " Cactus " Sh.a., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2025/1214, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues " Cactus " Sh.a., janë parashtruar si në vijim:

Kronologjia e fakteve dhe Analiza e Ankesës

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), parashtrojmë Ankesë ndaj vendimit të autoritetit kontraktues.

Më datën 24.11.2025, kemi paraqitur një kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit

Kontraktues, duke paraqitur faktet dhe dëshmitë që vërtetojnë se është kryer shkelje e ligjit të prokurimit publik dhe akteve nënligjore gjatë vlerësimit të ofertave, më konkretisht në lidhje me ofertën tonë të paraqitur, në këtë rast, nga kompania CACTTUS.

Më datën 27.11.2025, kemi marrë vendimin nga ana e Autoritetit Kontraktues, i cili ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim, duke ofruar arsye të pabazuara dhe që janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik.

Pas shqyrtimit të arsyetimit të vendimit nga Autoritetit Kontraktues, Operator Ekonomik

"Cactus" Sh.a. paraqet kundërgargumentet në vijim, të cilat dëshmojnë se qëndrimi i AKsë

për mospranimin e certifikatës PRINCE2 Foundation si ekuivalente me PMP është I pabazuar, i paargumentuar profesionalisht dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, veçanërisht parimin e barazisë dhe konkurrencës.

2. Vlerësimi i AKsë është subjektiv dhe nuk mbështetet në standarde ndërkombëtare AK konkludon se PRINCE2 Foundation nuk është ekuivalente me PMP, pa u mbështetur në:

- politikat e PMIsë (institucioni zyrtar për PMP),
- standardet e Axelos/PeopleCert (organi certifikues për PRINCE2),
- standardin ndërkombëtar ISO 21500 mbi menaxhimin e projekteve,
- ndonjë analizë të pavarur të tregut apo burim profesional të verifikueshëm. Mungesa e referencave të tilla e bën vlerësimin e AKsë subjektiv, kundër pretendimit se është “vlerësim objektiv i certifikatave”.

3. PRINCE2 Foundation është certifikim profesional ndërkombëtar, i njohur dhe I përdorur gjerësisht

Pretendimi i AKsë se PRINCE2 Foundation është “orientues” dhe jo certifikim profesional është i gabuar dhe nuk përputhet me informacionet zyrtare të PeopleCert.

PRINCE2 Foundation:

- është certifikim ndërkombëtar i standardizuar sipas metodologjisë PRINCE2,
- konfirmon njohuritë e strukturuar mbi proceset, rolet dhe praktikat bazë të menaxhimit të projekteve,
- përbën kriter të vlefshëm minimal kur kërkohet “certifikim profesional në menaxhim projekti”,
- kërkohet dhe aplikohet gjerësisht në sektorin publik dhe privat në BE dhe vende të tjera zhvilluara.

Ndërsa është nivel hyrës, mbetet certifikim profesional ndërkombëtar, dhe mungesa e ndonjë specifikimi për nivel të avancuar në DT e bën përjashtimin e tij të pajustificuar.

Gjithashtu, kandidati ynë ka përvojën përkatëse në rol menaxherial projektsh, që në kombinim me certifikimin përmbush kërkesën për pozicionin e Menaxherit të Projektit.

5. Argumenti i AK mbi “nivele Bloom” është teknikisht i pasaktë dhe i paaplikueshëm AK pretendon se PRINCE2 Foundation nuk është profesional sepse “teston vetëm nivelin Bloom 1 dhe 2”. Ky pretendim nuk ka bazë teknike, pasi:

- PMI, IPMA dhe PeopleCert nuk klasifikojnë certifikimet sipas niveleve të Bloomit,
- PeopleCert nuk e përdor klasifikimin Bloom në dokumentacionin për PRINCE2,
- edhe PMP përfshin një numër të konsiderueshëm pyetjesh që matin njohuri teorike, jo vetëm aftësi të avancuara.

Për rrjedhojë, konkludimi i AKsë është interpretim i lirë dhe jo fakt profesional.

6. AK ka bërë krahasime selektive dhe ka futur standarde që nuk janë përmendur në DT

Në dokumentacionin e tenderit:

- nuk kërkohet PRINCE2 Practitioner,
- nuk kërkohet IPMA Level C/B,
- nuk përcaktohet që certifikimi duhet të jetë “nivel i avancuar”.

Megjithatë, AK i ka përdorur këto certifikime si bazë krahasimi, duke futur kritere të reja të pa paraparë në DT. Kjo qasje bie ndesh edhe me vetë LPP-së, që ndalon vendosjen e kritereve pas hapjes së ofertave, si dhe e bën vlerësimin selektiv dhe jo të objektivizuar.

7. Metodologjitë ndërkombëtare të menaxhimit të projekteve janë të barazvlershme në standardet ISO – prandaj PRINCE2 Foundation përmbush kriterin minimal

Sipas standardit ISO 21500 dhe praktikave ndërkombëtare:

- PMP (PMI), PRINCE2 (PeopleCert) dhe IPMA janë metodologji të barabarta në fushën e menaxhimit të projekteve,
- dallojnë vetëm në qasje dhe strukturë, jo në legjitimitetin profesional,
- asnjë prej tyre nuk hierarkizohet ligjërisht mbi tjetrën, siç ka bërë AK.

Prandaj, kur DT kërkon thjesht “certifikim profesional të menaxhimit të projekteve”, atëherë PRINCE2 Foundation e plotëson këtë kërkesë. Përrjashtimi i tij është i pajustificuar dhe kufizues.

Shprehim pakënaqësinë tonë të thellë ndaj vendimit të marrë nga Autoriteti Kontraktues, i cili konsiderohet nga ana jonë i padrejtë, jo profesional, i pabazuar dhe i tendencioz, si dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet dhe dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky vendim cenon rëndë të drejtën tonë për pjesëmarrje në një proces të drejtë, transparent dhe konkurrues të prokurimit publik.

Për më tepër, vendimi bie në kundërshtim të rreptë me vetë qëllimin e Ligjit për Prokurimin Publik, i cili përcakton qartë se:

“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, transparente dhe të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike, si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomikë, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.”

Ne jemi eliminuar pavarësisht se kemi ofruar tenderin më të përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë Grupi i operatoreve ekonomik “RENER” SH.P.K. dhe PBC sh.p.k.– ne kemi ofruar çmimin prej 39,369.96 €, që është 39,470.04 € (49.93 %) më lire se oferta e operatorit të rekomanduar për kontratë me çmimin e ofruar prej 78,840.00 €.

II. Pretendimet ankimore

1. Kundërshtimi i Vendimit të AK-së

Kundërshtojmë vendimin e Autoritetit Kontraktues, i cili është marrë në mënyrë të pambështetur dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Vlerësimi ka prodhuar një rezultat të cilifikuar si i pasaktë, si në aspektin faktik, ashtu edhe në atë proceduror, duke cenuar pjesëmarrjen tonë të ligjshme në një proces konkurrues.

III. Paqartësia dhe paligjshmëria e arsytimit të AK Në njoftimin e vendimit, ndër të tjera thuhet:

Citim:

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm për arsye se: Ne NJK dhe ne dosje te tenderit eshte kërkuar 1 (një) Menaxher projekti – Bachelor i Shkencave Kompjuterike ose Inxhinierisë Kompjuterike ose Telekomunikacionit, me përvojë pune minimum 5vjeçare pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server)), i certifikuar me certifikatë valide PMP ose ekuivalente.

Ndërsa ju ne ofertën tuaj keni ofruar menaxherin me certifikate PRINCE2 Foundation dhe ITIL Foundation. Certifikata PRINCE2 Foundation përfaqëson vetëm nivelin bazik të

metodologjisë PRINCE2 dhe nuk dëshmon kompetencë profesionale në menaxhimin e projekteve.

Certifikata ITIL Foundation nuk ka të bëjë me menaxhimin e projekteve, por me menaxhimin e shërbimeve të IT. Si rezultat, kriteri për PMP ose ekuivalent nuk është I përmbushur.

Ky arsyetim është faktikisht i pasaktë, juridikisht i gabuar, i pakonfirmuar në burime zyrtare profesionale dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar nga OE.

IV. Shkeljet gjatë vlerësimit dhe argumentet tona

1. Plotësimi i kërkesës për certifikatë “PMP ose ekuivalente”

Si OE kemi plotësuar në tërësi këtë kërkesë të Dosjes së Tenderit. Në ofertën tonë, për pozicionin Menaxher i Projektit, janë dorëzuar:

- Certifikata PRINCE2 – certifikim profesional ndërkombëtar në menaxhimin e projekteve, i standardizuar sipas metodologjisë PRINCE2 dhe i pranuar gjerësisht si ekuivalente me PMP dhe i përdorur gjerësisht nga administratat publike dhe sektori privat në BE, Mbretërinë e Bashkuar, organizatat ndërkombëtare dhe industrinë e teknologjisë.

Kjo certifikatë plotëson plotësisht kërkesën “PMP ose ekuivalente”.

- Certifikata ITIL – certifikim profesional shtesë në menaxhimin e shërbimeve IT, i cili rrit edhe më tej nivelin e kualifikimit të menaxherit të propozuar dhe përvojën e tij në projekte të zhvilluara në platforma Microsoft (.NET dhe SQL Server).

Të dy certifikatat janë:

- të vlefshme,
- të dorëzuara ashtu siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë,
- pjesë e dokumentacionit teknik të ofertës.

Prandaj, konstatimi se “mungon certifikata PMP ose ekuivalente” është i pasaktë, pasi certifikimi PRINCE2 është paraqitur dhe përmbush kriterin e ‘ose ekuivalente’, siç është

formuluar në DT.

2. Kërkesa e Dosjes së Tenderit është “PMP ose ekuivalente”

Dosja e Tenderit përcakton qartë:

“Certifikatë valide në PMP ose ekuivalente.”

Në mungesë të:

- përcaktimit të nivelit të detyrueshëm të certifikimit,
- kritereve të detajuara të ekuivalencës,
- përshkrimit të standardeve që duhet të përmbushë certifikata alternative,

AK nuk ka të drejtë të përjashtojë një certifikim ndërkombëtar ekzistues pa bazë profesionale.

Në praktikën ndërkombëtare dhe sipas standardit ISO 21500, metodologjitë PMI, PRINCE2 dhe IPMA trajtohen si qasje të vlefshme dhe të krahasueshme në fushën e menaxhimit të projekteve. Për këtë arsye, certifikimi PRINCE2 është i pranueshëm si alternativë valide në mungesë të specifikimeve shtesë në DT.

3. Konstatimi i papërgjegjshmërisë është i gabuar

Duke qenë se:

- certifikimi profesional i kërkuar është paraqitur (PRINCE2),
- DT nuk ka përcaktuar nivel të certifikimit për ekuivalencë,
- asnjë standard krahasues nuk është përmendur në DT,
- dokumentet tona janë dorëzuar plotësisht dhe në përputhje me kërkesën, atëherë shpallja e ofertës sonë si të papërgjegjshme është konstatim i gabuar, si në aspektin faktik, ashtu edhe juridik dhe është bërë në kundërshtim me DT dhe LPP.

V. Mungesa e shfrytëzimit të nenit 72 të LPP-së nga AK

Sipas nenit 72 të Ligjit për Prokurimin Publik, në rast të paqartësive të mundshme, AK ka të drejtë dhe detyrim të kërkojë sqarime ose informacione shtesë nga operatorët ekonomikë.

Në rastin konkret:

- AK nuk ka kërkuar asnjë sqarim,
- nuk ka përdorur të drejtën ligjore për të eliminuar një paqartësi të pretenduar,
- ka marrë vendim vetëm mbi interpretim të njëanshëm, pa komunikim me OE.

Kjo tregon se oferta jonë ka qenë e plotë, ndërsa AK nuk ka vepruar në përputhje me parimet e transparencës dhe proporcionalitetit.

VI. Kërkesa nga OE

Bazuar në të gjitha argumentet e mësipërme, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues:

1. Rishqyrtimin e vendimit të AKsë, sipas nenit 99 të LPPsë.
2. Korrigjimin e konstatimit për mungesë të certifikatës “PMP ose ekuivalente”.
3. Rivlerësimin e ofertës sonë në përputhje me DT dhe LPP.
4. Rikthimin e ofertës në procedurë, pasi eliminimi është bërë në mënyrë të gabuar dhe të pajustificuar

Dispozitat e shkelura nga ana e autoritetit kontraktues

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

3. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues

nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1 i cili thotë se:

1.Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ JoDiskriminimi

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen konkretisht pika 1,2,4 i cili thotë se:

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Neni 59 Ekzaminimi,

Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, pika 2 dhe 4 e këtij neni

Ne rastin konkret operatori ekonomik beson fuqishëm, qe nga ana e autoritetit kontraktues nuk është përfillur ky nen, konkretisht pika 2 dhe 4 i cili thotë se:

2. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4.Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi

në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekun e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 6571 të këtij ligji.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

E kemi shqyrtuar kërkesën tuaj për rishqyrtim dhe mund të konsiderojmë se pretendimet tuaja ankimore janë të pa bazuar, për arsytet e sqaruara nga Njësia e Kërkesës – SISH, si më poshtë:

Pas shqyrtimit të kërkesës suaj dhe dokumentacionit të dorëzuar, ju njoftojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës suaj mbetet i pandryshuar. Arsyeja kryesore është se certifikata PRINCE2® Foundation nuk mund të konsiderohet si ekuivalente e certifikimit të kërkuar PMP® ose ekuivalent profesional. Vendimi mbështetet në analizën objektive të përmbajtjes së certifikatave dhe standardeve të kërkuara në dosjen e tenderit.

Arsyet për këtë vendim janë si më poshtë:

Niveli i certifikimit

PRINCE2® Foundation është certifikim themelor, që vlerëson vetëm aftësinë për të kuptuar dhe kujtuar konceptet e metodës PRINCE2 (niveli Bloom 1 & 2). Ky certifikim nuk përfshin aplikim praktik të menaxhimit të projekteve dhe nuk kërkon përvojë pune.

Kërkesat profesionale dhe përvoja

Certifikimi PMP® dhe ekuivalentet profesionale kërkojnë:

Dokumentim të edukimit dhe përvojës profesionale në menaxhimin e projekteve;

Vlerësim përmes pyetjeve skenarike të situatave reale pune;

Aftësi për të aplikuar praktikat e menaxhimit të projekteve në projekte komplekse.

PRINCE2® Foundation nuk plotëson këto kërkesa, pasi teston vetëm njohuri bazike teorike dhe nuk garanton kompetenca profesionale të nivelit të avancuar.

Dallimi midis hyrjes dhe certifikimit profesional

Vetë syllabus-i i PRINCE2 Foundation e përcakton këtë certifikim si parakusht për nivelin Practitioner, që është certifikim profesional i avancuar. Pra, Foundation është orientues dhe edukativ, jo ekuivalent profesional me PMP®.

Mbështetje në standarde dhe praktikë të pranueshme

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar ekuivalencën sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikës së zakonshme profesionale, ku PRINCE2 Foundation nuk plotëson kriterin e përcaktuar në dosjen e tenderit për PMP ose ekuivalent profesional. Certifikata PRINCE2® Practitioner konsiderohet ekuivalente me PMP®, pasi përmban njohuri dhe kompetenca profesionale të nivelit të avancuar, të aplikueshme drejtpërdrejt në menaxhimin e projekteve komplekse. Certifikata IPMA Level C/B konsiderohet ekuivalente me PMP®, e cila përgatit menaxherë projektësh me aftësi të avancuara teknike, organizative dhe drejtuese, të vërtetuara përmes eksperiencës praktike dhe vlerësimit profesional.

Përfundim

Bazuar në këto fakte, oferta juaj nuk mund të pranohet, sepse nuk përmbush kriterin e kërkuar për menaxherin e projektit me certifikim PMP ose ekuivalent profesional. Vendimi për eliminim nga procedura e tenderit mbetet i vlefshëm dhe i drejtë sipas dokumentacionit të tenderit dhe Ligjit për Prokurimin Publik.

Logjika e OE ankues për përllogaritjen e kostove të stafit për këtë projekt nuk është reale, por është tendencë për ngritjen me çdo kusht të vlerës së projektit. Kjo logjikë për vlerën e projektit do të arsyetohej sikur stafi i ofruar në këtë projekt të angazhohej vetëm në këtë projekt dhe në asnjë kontratë tjetër paralelisht për 36 muaj. Ndërsa ju, OE, me të njëjtin staf profesional aplikoni në tenderët e tjerë paralelisht dhe realizoni kontrata të shumta njëkohësisht.

Ky aktivitet është tenderuar me procedurë të hapur dhe mund të ofertojë cilido nga OE të interesuar. Është e drejtë dhe përgjegjësi e AK të përcaktojë vlerën e një aktiviteti të prokurimit, ndërsa është e drejtë e juaja të ofertoni ose të mos ofertoni në këtë aktivitet.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 11.12.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2025/1214, ndërsa me datë 18.12.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1214, me rekomandimet si në vijim Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrirat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE" Cactus " Sh.a., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1214 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin ankimor nr 1 .

OE ankues tek pretendimi ankimor thekson se AK-Ministria e Shëndetësisë ofertën tonë e cilëson si të papërgjegjshme me arsyetimin se:

Tenderi juaj është i papërgjegjshëm për arsye se: Ne NJK dhe ne dosje te tenderit eshte kërkuar 1 (një) Menaxher projekti – Bachelor i Shkencave Kompjuterike ose Inxhinierisë Kompjuterike ose Telekomunikacionit, me përvojë pune minimum 5vjeçare pas

diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server)), i certifikuar me certifikatë valide PMP ose ekuivalente.

Ndërsa ju ne ofertën tuaj keni ofruar menaxherin me certifikate PRINCE2 Foundation dhe ITIL Foundation. Certifikata PRINCE2 Foundation përfaqëson vetëm nivelin bazik të metodologjisë PRINCE2 dhe nuk dëshmon kompetencë profesionale në menaxhimin e projekteve.

Certifikata ITIL Foundation nuk ka të bëjë me menaxhimin e projekteve, por me menaxhimin e shërbimeve të IT. Si rezultat, kriteri për PMP ose ekuivalent nuk është i përmbushur.

Sipas OE Cactus Ky arsyetim është faktikisht i pasaktë, juridikisht i gabuar, i pakonfirmuar në burime zyrtare profesionale dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar nga OE.

- Eksperti shqyrtues sqaron se kërkesa dhe dëshmia ne dosje te tenderit ne lidhje me ketë kriter ka qenë si ne vijim:

Kërkesa:

1 (një) Menaxher të projektit- Bachelor i shkencave kompjuterike ose inxhinierisë kompjuterike ose telekomunikacion, me përvojë pune minimum 5 vjeçare pas diplomimit në menaxhimin e projekteve të natyrës së ngjashme (të zhvilluara në platformën Microsoft (.NET me SQL Server)), i certifikuar me certifikatë valide në PMP ose ekuivalente.

Dëshmia:

Dëshmite 3 (a,b,c): Kopje e diplomës, CV, Deklaratë për caktimin e Menaxherit të projektit, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt, Kopjen e certifikatës për menaxhim dhe vegëzën përkatëse për verifikim online.

OE ankues (Cactus) ne dosje te tenderit ka ofruar dy certifikime ne emër te menaxherit te kontratës te cilat janë si ne vijim:

ITIL® Foundation Certificate in IT Service Management dhe

PRINCE2® 7 Foundation in Project Management

Nga hulumtimet e bëra per krahasueshmerin e këtyre certifikave rezulton si me poshtë:

- Certifikata Prince 2 dhe PMP janë certifikata ne fushën e menaxhimit te projekteve ndërsa certifikata

- ITIL është certifikace ne fushën e menaxhimit te shërbimeve te IT-së (IT Service Management)

Nga përshkrimi i mesiperme dhe hulumtimet e bëra ne web faqe te ndryshme te internetit kemi ardhur deri te perfundimi se Certifikatat ITIL, të cilat kanë për fokus menaxhimin e shërbimeve IT, nuk konsiderohen ekuivalente me PMP, pasi nuk mbulojnë fushën e menaxhimit të projekteve sipas kërkesës së përcaktuar në dosjen e tenderit ndërsa certifikata PRINCE2® 7 Foundation in Project Management është certifikate ne fushën e menaxhimit te projekteve.

Gjatë shqyrtimit kemi konstatuar se:

PMP (Project Management Professional) është certifikatë ndërkombëtare e njohur që vërteton kompetenca profesionale në menaxhimin e projekteve.

Ne këtë rast një Certifikatë ekuivalente duhet të jenë certifikata që:

kanë fokus të drejtpërdrejtë në Menaxhim të Projekteve

vërtetojnë njohuri dhe kompetenca të krahasueshme me PMP,

janë të njohura ndërkombëtarisht dhe të aplikueshme në menaxhimin e projekteve.

- PRINCE2® 7 Foundation in Project Management mbulon metodologjin e projekteve edhe pse është nivel bazik, jep strukturën, parimet, dhe fazat e menaxhimit të projektit. Kjo është pjesë e rëndësishme që e kërkon edhe PMP.

Pasi që AK-Ministria e Shëndetësisë ka përcaktuar në dosje të tenderit se lejon edhe “ekuivalente”, konstatohet se Çertifikata PRINCE2® 7 Foundation in Project Management mbulohet pikat kyçe që kërkohen në dosje të tenderit sipas përshkrimit të specifikimeve teknike të dosjes së tenderit.

Konstatohet që AK-Ministria e Shëndetësisë nuk ka dhënë ndonjë dëshmi apo sqarim mbi arsyen e eliminimit të certifikatave PRINCE2® 7 Foundation in Project Management në favor të PMP duke mos bërë ndonjë krahasueshmeri në mes të këtyre dy certifikatave, andaj bazuar në përshkrimin e mësipërm konstatohet se kemi të bëjmë me pretendim ankimor pjesërisht të bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Secili Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të kontraktues dëgjohen në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me Ligjin për Prokurim Publik.

Bazuar në përshkrimin e bërë me sipër, pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, dosjes së tenderit, ofertës së Operatorit Ekonomik ankues dhe në tërësi në bazë të përshkrimit dhe sqarimeve të lartcekura rekomandojmë Panelin Shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar dhe të anulohet vendimi i AK-së mbi dhënien e kontratës i datës 19.11.2025.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2025/1214 i dorëzuar me dt. 18.12.2025, i hartuar me kërkesën e OSHP lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore, për shkak se eksperti shqyrtues profesional hulumtimet e tij/saj i konstaton vetëm nga interneti dhe jo nga ndonjë njohuri e tij eksplicite të kësaj natyre, i cili po ashtu nuk ka kërkuar ndihmën e ekspertit shqyrtues teknik në përgjigje të pretendimeve ankimore që kanë pasur të bëjnë me çështje teknike të kësaj natyre, po ashtu i njëjti pretendimin kyç e kualifikon si pjesërisht të bazuar dhe rekomandimin se kjo lëndë duhet të kthehet në ri-vlerësim.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik. Pikërisht për këtë Paneli Shqyrtues kërkoj angazhimin e një ekspertit shqyrtues teknik nga teknologjia informative për të bërë një raport të ekspertizës dhe tu jepet përgjigje pretendimeve ankimore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues teknik është i hartuar me dt. 10.02.2026, me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Raportin e hartuar nga eksperti shqyrtues teknik, ju është dërguar të gjitha palëve. Ndryshe nga eksperti shqyrtues profesional, rekomandimi i ekspertit teknik është që ankesa të kualifikohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Megjithatë, Paneli shqyrtues vlerëson se në këtë rast nuk mund ta mbështesë në tërësi asnjërin raport, nisur nga neni 7 i LPP, trajtimi i barabartë, për shkak se, të dyja kanë ndryshime të mëdha dhe konsideron se lidhur me këtë AK konform nenit 59 të LPP të kërkon drejtpërdrejtë sqarime nga organet të cilat i kanë lëshuar këto certifikata, me qëllim të konstatojnë drejtë se këto certifikata të ankuesit a e plotësojnë kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Së dyti, Paneli Shqyrtues pa një vërtetim të drejtë të gjendjes faktike dhe reale nuk e merr mbi sipër përgjegjësinë që të pranoj certifikata tjera të cilat nuk janë adekuate për implementimin e

këtij projekti, ngase, mund të ketë pasoja dhe rreziqe gjatë realizimit.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues vendos që të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja dhe Avancimi i Sistemit të E- Recetave dhe Sistemit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësorë (HIFIS)” me nr. të prokurimit: 206-25-7982-2-1-1., iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë, dhe lëndën ta kthejë në ri-vlerësim dhe AK të veprojë konform udhëzimeve të dhëna nga ky Panel Shqyrtues.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK nuk janë konform nenit 59 të LPP, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues profesional dhe ekspertit teknik lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër, përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetin e prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 dhe 4, lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - " Cactus " Sh.a.**
- Arkivës së OSHP-së: